



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 478/14 prot.

Datë 17.03.2026

V E N D I M

Nr. 404/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.03.2026 me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 330/2026, datë 03.03.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

Ankimues: Operatori ekonomik BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK me NIPT M38106801F, me adresë: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1, Mallakastër.

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me NIPT (L81506043D) dhe adresë: Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze, Tirane, Tirane zona kadastrale 8150 ,numri i pasurise 8/801.

Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A, me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

“OPTIMA COMMUNICATION” Sh.p.k me Nipt K71903025A dhe Adresë: Rruga Shyqyri Bexolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durres me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 03.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 330/2026, ku vendosi:

1. “Të pranojë ankesën e BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Instant” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC Store” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
4. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
5. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
6. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Idealdevs Corporation” SHPK & “Ervald Rosaj” SHPK, nga operatori ekonomik “Instant” SHPK, nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK si dhe nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr. 800/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën nr. 478/11 prot., datë 13.03.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 330/2026 datë 03.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 800/1 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën nr. 478/11 prot., datë 13.03.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 330/2026 datë 03.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi sipas vendimit nr. 330/2026 datë 03.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorët ekonomik në përputhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

